


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 4964 Rep.

Nr. 1417 Kol.



KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
MMT SHPK

Sot me date 18/10/2017 (dymije e shtatembdhjete) , ne dhomen e Notereve ne Tirane para meje Noter HELIAN ZENELAJ , me Seli ne rrugen "Kont Urani" Nr. 3, u paraqiten personalisht palet kontraktuese me cilesite e meposhteme :

Z. Ilir Lamçe atesia Seri, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 10/08/1971, dhe banues ne Tirane rr "Jordan Misja" Pall 141, Shk 2, Ap 10, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes identiteti me Nr. Personal Leternjoftimi H10810158D

(Ketu e meposhte referuar si "**Shitesi**")

Z. Vinçens Itellari atesia Leonard, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 26/06/1993, dhe banues ne Tirane rr "M.Shyri" Pall 49, Shk 1, Ap 11, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.Personal Leternjoftimi J30626067F;

(Ketu e meposhte referuar si "**Bleresi**")

Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si "**Palët**".

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë te Shitjes së kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE:

- Shitësi zotëron 100% të kapitalit me një vlerë totale prej 100,00 Lekë të shoqërisë "MMT" sh.p.k, me Nr. N.I.P.T: L42221010A, (këtu e mëposhtë referuar si "Shoqëria").
- Blerësit nuk zotërojnë pjese të kapitalit të shoqërisë "MMT" sh.p.k, me Nr. N.I.P.T: L42221010A.

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, 60% të kapitalit të shoqërisë të barabarta me 60 Kuota/pjese, me një vlerë të përgjithshme prej 60.000 Leke. Shitësi mbetet me 40 % të kapitalit të barabartë me 40 kuota /pjese në barasvlefshme në 40.000 Leke.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndryshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi është kryer përkundrejt çmimit prej 60.000 (gjashtedhjetemije) Lekë.
- 2.2 Palët deklaron se çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotëruar të 60% të kapitalit të Shoqërisë të barabarta me 60 kuota Z. Vinçens Itellari të barabarta me 60 Kuota/pjese, duke u bërë titullare të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Neni 4

Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësit se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.



Neni 5

Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardollos dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmbajtje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qendror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 9

Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.

Neni 10

Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12

Gjuha e kontratës

- 12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.
12.2 Kontrata mbasi ju lexua paleve me ze te larte dhe te qarte dhe ata deklaruan se e kuptuan permbajtjen dhe pasojat ligjore te saj e nenshkruajne rregullisht para meje noterit dhe une noterit e vertetoj ne baze te ligjit . Kontrata e shitjes u redaktua ne baze te nenit 705 e vijusa te Kodit Civil .

PALET

SHITËSI

Ilir Lamçe

BLERËSI

Vingens Itellari



NOTER
HELINTRAJ
CP 10000